



Kryesuesi i Kuvendit

02 Nr. 400/01-2186/22
Dt. 01.02.2022

Duke u bazuar në nenin 14 paragrafi 14.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare në Organizatat Buxhetore, Rregullores së brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare 05Nr. 404/01-29878/18, nenit 57 dhe 58 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË
JOFINANCIARE

I

THEMELOHET komisioni për vlerësimin e pasurisë jofinanciare në përbërje prej:

1. Fitim Spahiu – kryesues i komisionit,
2. Omer Memiši, anëtar,
3. Arben Hyseni – anëtar.

II

Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë financiare dhe jo financiare për të vertetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizimin, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësi të tjera të organizatës.

III

Detyrë e komisionit është ta bëjë vlerësimin e pasurisë së identifikuar si pasuri në gjendje të rregullt por që nuk është duke u përdorur, apo vlerësimin e pasurisë së dëmtuar apo jashtë përdorimit dhe në bazë të vlerësimit të jep rekomandime si në vijim:

1. Pasuria të transferohet në ndonjë departament tjetër të komunës që ka nevojë për aset të till,
2. Të kaloj në procedurë të shtjjes,
3. Të falet ndonjë organizatë në nevojë apo
4. Të asgjësohet.

IV

Komisioni duhet të bëjë vizita nëpër zyrët, departamentet apo objektin ku gjenden asetet dhe varësisht nga konstatimi i gjendjes përpilon raportin i cili përmban dhe rekomandime.

V

Raporti i përfunduar dhe i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dorëzohet te departamentet përgjegjëse: ZKA, ZKF, dhe Drejtori i Financave.

VI

Në bazë të rekomandimeve nga raporti, ZKA merr vendim për hyrje në procedurë të tjetërsimit të pasurisë.

VII


Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 02 Nr.404/1-24670.

VIII

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

- *Vendimi i'u dërgohet:*
 - *Anëtarëve të komisionit,*
 - *Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,*
 - *Arkivës së Kryetarit.*

Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality



- Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/02-2667/12

Dt.01.02.2022

D r a g a s h

Në bazë të udhëzimit të zyrës për prokurimit të dt.01.02.2022 për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit - ANKANDI, nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit nr.06-103/1 i dt.11/09/2008, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M


- I. **AUTORIZOHET** Zyra e Prokurimit **TË SHPALL** ankandi: "Shitja e asetave komunale jashtë përdorimit – 2022", , duke i respektuar procedurat ligjore.
- II. Për implementimin e Vendimit **OBLIGOHET** Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse të Komunës.
- III. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Shtojcë: Kërkes

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit të Komunës,
- Drejtorisë përkatëse,
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Rezet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 40/2022 - 2669/pv

Dt. 01.02.2022

D r a g a s h

Ne bazë të neneve 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:


V E N D I M

- I. z. **Vetim Ramadani** **CAKTOHET** zyrtar autorizues për secilin aktivitet të prokurimit nga njësia kërkuese e Drejtorisë për Administratë të Komunës.
- II. Për implementimin e Vendimit përkuajdeset Zyra e Prokurimit të Komunës Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe vlen derisa nuk ndryshohet me Vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- z. **Vetim Ramadani**,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës Dragash, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës
02 Nr. *Ljosa* / *2456* / *2022*
Dt. 01.02.2022
D r a g a s h

Në bazë të neneve 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:


V E N D I M


- I. z. **Bean Hadžiasan** **CAKTOHET** zyrtar autorizues për secilin aktivitet të prokurimit nga njësia kërkuese e Drejtorisë për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit të Komunës.
- II: Për implementimin e Vendimit përkujdeset Zyra e Prokurimit të Komunës Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe vlen derisa nuk ndryshohet me Vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- z. **Bean Hadžiasan**,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës Dragash, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragash /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/07 - 2460/n

Dt. 01.02.2022

Dragash

Në bazë të neneve 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. z. Qamil Kolloni **CAKTOHET** zyrtar autorizues për secilin aktivitet të prokurimit nga njësi kërkuese e Drejtorisë për Ekonomi, Financa, Buxhet dhe Zhvillim të Komunës.
- II. Për implementimin e Vendimit përkujdeset Zyra e Prokurimit të Komunës Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe vlen derisa nuk ndryshohet me Vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- z. Qamil Kolloni ,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës Dragash, dhe
- Arkivit



Kryetari i Komunës
Behar Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/01-2663/22

Dt. 01.02.2022

Dragash

Në bazë të neneve 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:


V E N D I M

- I. z. Behar Brenoli **CAKTOHET** zyrtar autorizues për secilin aktivitet të prokurimit nga njësia kërkuese e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës.
- II. Për implementimin e Vendimit përkujdeset Zyra e Prokurimit të Komunës Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe vlen derisa nuk ndryshohet me Vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- z. Behar Brenoli,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës Dragash, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Behar Xhaladini





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 450/e1 - 2465/22

Dt. 01.02.2022

Dragash

Në bazë të neneve 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. z. Selim Kryeziu **CAKTOHET** zyrtar autorizues për secilin aktivitet të prokurimit nga njësia kërkuese e Drejtorisë për Arsim të Komunës.
- II. Për implementimin e Vendimit përkujdeset Zyra e Prokurimit të Komunës Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe vlen derisa nuk ndryshohet me Vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- z. Selim Kryeziu,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës Dragash, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Bechet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragas/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. Lp/01/2224/22

Dt. 02.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 57 dhe 59 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

AUTORIZOHET z.Omer Memiši dhe z.Sulejman Jonuzi zyrtar në zyrën e tatimit në pronë në Komunën e Dragashit, që të i nënshkruajn të gjitha dokumentet që lëshohen nga zyra e tatimit në Pronë dhe zyra e financave.

II

Ky autorizim u jepet me qëllim të funksionimit më të mirë të zyrës së tatimit në pronë.

III

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e kryetarit të komunës.

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini

- **Vendimi u dërgohet:**
- Të autorizuarve,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrës së pritjes - protokollit
- Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragas/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 1/00/01-2257/12

Dt. 02.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja f të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); në bazë të kërkesës 09.Nr.324/01-2110 të datës 26.01.2022 nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT NË AKTIVITETIN, NUMËRIMI-INVËNTARIZIMI I NUMRIT TË KAFSHËVE TË EGRA, SHTËPIVE, OBJEKTEVE TEKNIKE NË VEND GJUETI NË DRAGASH

I

EMËROHET komisioni prej 5 anëtarëve në përbërje prej:

1. Sherif Sylejmani BSC për Pyje e Mjedis, Kryetar,
2. Jenuz Ibrahimimi tek. i Pylltarisë-anëtar,
3. Shaban Kaleshi roje pylli dhe gjahu-anëtar,
4. Fejzi Skenderi roje pylli dhe gjahu- anëtar,
5. Abdylrezak Memeti nga sektori për bujqësi- anëtar

II

1. Detyrat e komisionit është që në mënyrë profesionale të përshkruaj dhe evidentoj shtëpitë e gjahtarëve dhe objektet teknike të gjuetisë brenda territorit të përgatitur për themelimin e gjuetisë, që është jashtë kufijve të PK "Sharri" dhe zonave tjera eventuale.
2. Komisioni të gjitha të dhënat e grumbulluar dhe të përpunuara t'i dërgoj në këtë Drejtori me qëllim të analizimit dhe krijimit të bazës për themelimin e Vendgjuetisë " Sharri-Šar" në teritorin e komunës së Dragashit.
3. Këto të dhëna duhet të mblidhen dhe përpunohen e dërgohen në këtë drejtori më së voni deri më 15.02.2022

III

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari i komunës

Shtojcë: Kërkesa nr. 09/324/01-1828

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini

- Vendimi u dërgohet:
 - Anëtarëve të komisionit,
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
 - Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/pa-2368/pa

Më 04.02.2022

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

I

Të SIGUROHEN mjete për kartela - mbushje telefonike në vlerë prej 20€ (Njëzet Euro) në muaj për z. Ymer Ejupi – zyrtar për Financa në DKA dhe të vazhdohet deri sa të ushtrojë këtë funksion në komunën e Dragashit.

II

Për implementimin e këtij Vendimi Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

III

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet :

- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës,
- Kryetarit të Komunës – Dragash dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Dr. Baxhet Xheladini





Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 112/02-2553/22

Dt. 08.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja f dhe nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008),), nenit 5 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

I

z.Liridona Misinaj, emërohet në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

II

Mandati i drejtorit do të fillon nga data 08.02.2022 dhe do të jetë i njëjtë me mandatin e kryetarit të Komunës. Emërimi i bërë me këtë vendim mund të rishqyrtohet në çdo kohë nga ana e kryetarit të Komunës.

III

Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit të Drejtorisë, janë të përcaktuara me Ligjin nr.-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Dragashit dhe udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të Komunës si dhe në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

IV

I emëruari do ti raportoj rregullisht kryetarit të Komunës për procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin e Drejtorisë që e udhëheqë.

V

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kabineti i Kryetarit, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

VI

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Shtojcë: Leternjoftimi

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini



- Vendimi iu dërgohet:
 - Të emëruarit,
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
 - Sektorit të Personelit,
 - Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 1400/01-7659/22

Dt. 09.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 5 i Rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, kërkesës 05 Nr.114-27/22 e datës 07.02.2022, kërkesës 05 Nr. 114-28/22 e datës 07.02.2022, 05 Nr. 114-29/22 e datës 07.02.2022 nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

LEJOHEN mjetet financiare për punë jashtë orarit të punës për Rojet e Pyllit:

1. Jeton Krasniqi – Përgjegjës i Nj. Pyjore – Dragash,
2. Jenuz Ibrahimimi – Roje Pylli,
3. Shaban Kaleshi – Roje Pylli,

II

Punën jashtë orarit e kanë kryer me dt. 08.12.2021, shuma e llogaritur sipas kërkesave të lartëcekura është 75.00€ (Shtatëdhjetë e pesë Euro) për secilin.

III

4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Shtojcë: kërkesat 05 Nr.114-791/2 e datës 08.12.2021, 05 Nr. 114-792/21 e datës 08.12.2021, 05 Nr. 114-790/21 e datës 08.12.2021.

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini

- Vendimi u dërgohet:
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrës Personelit,
- Arkivës së Kryetarit.





Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/01-2662/22

Dt. 09.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 5 i Rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, kërkesës 05 Nr.114-21/22 e datës 02.02.2022, kërkesës 05 Nr. 114-33/22 e datës 08.02.2022, nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

LEJOHEN mjetet financiare për punë jashtë orarit të punës për z. Armend Piraj – Inspektor Komunal.

II

Punën jashtë orarit e kanë kryer nga data 25 01.2022 deri më 28.01.2022, shuma e llogaritur sipas kërkesave të lartëcekura është 140.00 € (Njëqindë e katërdhjet Euro).

III


4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Shtojcë: kërkesa 05 Nr.114-21/22 e datës 02.02.2022,
kërkesa 05 Nr. 114-33/22 e datës 08.02.2022

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrës Personelit,
- Arkivës së Kryetarit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/01-2663/22

Dt. 09.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 5 i Rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, kërkesës 05 Nr.114-20/22 e datës 02.02.2022, kërkesës 05 Nr. 114-32/22 e datës 08.02.2022, nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

LEJOHEN mjetet financiare për punë jashtë orarit të punës për z. Enis Sylejmani – Inspektor i Tregut.

II

Punën jashtë orarit e kanë kryer nga data 25 01.2022 deri më 28.01.2022, shuma e llogaritur sipas kërkesave të lartçekura është 140.00 € (Njëqindë e katërdhjet Euro).

III

4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Shtojcë: kërkesa 05 Nr.114-20/22 e datës 02.02.2022,
kërkesa 05 Nr. 114-32/22 e datës 08.02.2022

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrës Personelit,
- Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/09-2664/22

Dt. 09.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 5 i Rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, kërkesës 05 Nr.114-27/22 e datës 07.02.2022, kërkesës 05 Nr. 114-28/22 e datës 07.02.2022, 05 Nr. 114-29/22 e datës 07.02.2022 nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

LEJOHEN mjetet financiare për punë jashtë orarit të punës për Rojet e Pyllit:

1. Jonuz Ibrahimimi – Roje Pylli,
2. Hazir Shabani – Roje Pylli,
3. Shaban Kaleshi – Roje Pylli,

II

Punën jashtë orarit e kanë kryer me dt. 07.02.2022, shuma e llogaritur sipas kërkesave të lartëcekura është 19.80€ për secilin (Nëntëmbdhjetë Euro e tetëdhjetë cent).

III

4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Shtojcë: kërkesat 05 Nr.114-27/22 e datës 02.02.2022, 05 Nr. 114-28/22 e datës 07.02.2022, 05 Nr. 114-29/22 e datës 07.02.2022,

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrës Personelit,
- Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/01-2758/22

Më 11.02.2022

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

I

Të SIGUROHEN mjete për kartela - mbushje telefonike në vlerë prej 30€ (Tridhjet Euro) në muaj për z. Liridona Misinaj – Drejtoresh e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të vazhdohet deri sa të ushtrojë këtë funksion në komunën e Dragashit.

II

Për implementimin e këtij Vendimi Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

III

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet :

- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës,
- Kryetarit të Komunës – Dragash dhe
- Arkivit



Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/64-2946/22

Më 14.02.2022

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

I

Të SIGUROHEN mjete për kartela - mbushje telefonike në vlerë prej 30€ (Tridhjet Euro) në muaj për z. Fejsal Halilović – Nënkyetar i Komunës nga radhët e Komuniteteve dhe të vazhdohet deri sa të ushtrojë këtë funksion në komunën e Dragashit.

II

Për implementimin e këtij Vendimi Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

III

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet :

- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës,
- Kryetarit të Komunës – Dragash dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Dragashit – Opština Dragaš – Municipality of Dragash

-Kryetari i Komunës
02 Nr.352/01-2955/22
Dt:14.02.2022
Dragash

Në bazë të Marrëveshjes për Bashkëfinancim me nr.02 Nr.352/01-2955 e dt.11.02.2022 e lidhurë në mes të: KRM "EKOREGJIONI" SH.A dhe Komunës së Dragashit, nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008, nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit nr.06-103/1 i dt.11.09.2008, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **TË EKZEKUTOHET** për pagesë lëndë me Nr.02 Nr.352/01-2955/22 e dt.11.02.2022, në bazë të Marrëveshjes për Bashkëfinancim e lidhur në mes të KRM "EKOREGJIONI" SH.A dhe Komunës së Dragashit.
- II. Ekzekutimi i mjeteve të bëhet nga pozicioni buxhetor për mallra e shërbime nga drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim, Shërbime Publike dhe Siguri të Komunës së Dragashit.
- III. Për implementimin e këtij Vendimi **OBLIGOHET** Drejtoria për Financa, Ekonomi e Zhvillim e Komunës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Shtojcë: Marrëveshja.

Vendimi u dërgohet :

- Drejtorive përkatëse të Komunës,
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Dr. *Bexhet Xheladini*



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës
02 Nr. 100/01-2979/22
Dt. 14.02.2022
D r a g a s h


Në bazë të neneve 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:


V E N D I M

- I. z. **Liridona Misinaj** **CAKTOHET** zyrtar autorizues për secilin aktivitet të prokurimit nga njësia kërkuese e **Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport të Komunës.**
- II. Për implementimin e Vendimit përkujdeset Zyra e Prokurimit të Komunës Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë dhe vlen derisa nuk ndryshohet me Vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- z. **Liridona Misinaj**,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës Dragash, dhe
- Arkivit


Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini



- Kryetari i Komunës
01/ Nr. 400/01-3018/22

Data: 15.02.2022

Dragash

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

1. EMËROHET z. Flurim Qengaj menaxher i projektit:
"Furnizim me dru (ahu,bungu) për ngrohje dhe sharritja e tyre për nevojat e Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2022" (procedura negocuar) (V=200mH)
(Furnizim me dru (ahu,bungu) për ngrohje - 200mH)
nr i prokurimit:(621-22-622-1-3-5), nr i brendshëm: (621-2022-001-135)
2. Për implementimin e Vendimit obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse të Komunës.
3. Detyrë e menaxherit është mbikëqyrja e projektit, hartimi i procesverbalit - raportit dhe njoftimi i organeve të lartëcekura, për procedurat e mëtejme.
4. Për veprimet e mëtejme të njoftohet kryetari i Komunës

Vendimi u dërgohet:

- Menaxherit të projektit - z. Flurim Qengaj
- Zyrës për Prokurim të Komunës,
- Drejtorisë përkatëse të Komunës
- Arkiva



Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/01-3037/22
Dt. 15.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

EMËROHET grupi punues për reformën e taksës së mbeturinave në përbërje prej:

1. Bashkim Emini – zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave – Kryesues,
2. Redžep Ibraimi – zyrtar për Shërbime Publike – anëtar,
3. Burim Aliu – zyrtar Kryesor Financiar – anëtar,
4. Armend Piraj – Inspektor Komunal – anëtar,
5. Nazim Dauti – përfaqësues nga Eko-Regjioni – anëtar dhe
6. Adem Emini – zyrtar Ligjor – anëtar.

II

Detyrë e komisionit është që të bëjë listën e dokumenteve dhe hapave të duhur të cilët duhet të ndërmerren për reformën e inkasimit të pagesës së mbeturinave nga Eko-Regjioni në Komunë.

III

Raporti i grupit punues të i dorëzohet Kryetarit deri më 29.04.2022.

IV

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Dr. Bexhet Xheladini

- Vendimi u dërgohet:
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 402/04-3060/22

Dt. 15.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008),neni 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

CAKTOHET z. Redžep Ibraimi , zyrtar për Shërbime Publike si anëtar i projektit për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh faza II-të 2021 – 2024.

II

Detyrë e të emëruarit është që të përcjell aktivitetet e JICA në teren dhe Komunë sipas nevojave të Komunës dhe projektit të lartëcekur.

III

Për aktivitetin e vet të i raportojë drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

IV

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Dr. Bexhet Xheladini

- Vendimi u dërgohet:
- Z. Redžep Ibraimi,
- Zyrës së – JICA-s në Kosovë ,
- Arkivës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 325/04-3225/22

Dt. 18.02.2022

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit nr.06-103/1 i dt.11.09.2008, kryetari i Komunës Dragash, miraton këtë:

V E N D I M

- I. THEMELOHET** Komisioni Komunal për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit elementare natyrore në Komunën e Dragashit, në përbërje:
- 1. z.Vetim Hasani - kryetar,**
 - 2. z.Fitim Spahiu - anëtar,**
 - 3. z.Redzep Ibraimi - anëtar.**
- II.** Detyrë e Komisionit është: evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit elementare natyrore në Komunën tonë, përpilimi i raportit, njoftimi dhe koordinimi i punëve me organet kompetente komunale.
- III.** Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit...
- Drejtoisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike të Komunës, dhe
- Arkivit



Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo



Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

Kryetari i Komunës

02 Nr. L.1-3308/22

Më 18.02.2022

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

I

Të **SIGUROHEN** mjete për kartela - mbushje telefonike në vlerë prej 20€ (Njëzet Euro) në muaj për zyrtarët e zyrës së Komuniteteve dhe kthim:

1. Uzair Hamza – Udhëheqës i zyrës,
2. Urmet Emini – Zyrtar Financiar,
3. Fitim Spahiu – Koordinator për kthim të qëndrueshëm.

II

Për implementimin e këtij Vendimi Obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

III

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.


Vendimi u dërgohet :

- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës,
- Kryetarit të Komunës – Dragash dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 404/22 - 3398/22

Dt. 21.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

Të sigurohen derivate për gjenerator për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme:

- Sh.f.m.u. " Ilmi bahtijari" – f.sh. Blaç, 30 litra në muaj
- Sh.f.m.u. " 28 Nëntori" – f.sh. Brodosanë, 30 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Samidin Emini - f.sh. Kuk, 20 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Ulina" – f.sh. Kosavë, 20 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Sezaï Surroi" – f.sh. Bellobrad, 30 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. "Shaban Shabani" – f.sh. Llopushnik, 30 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " 9 Maji " – f.sh. Rapç, 20 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. "Svetelosti" – f.sh. Krushevë, 20 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Restelica" – f.sh. Restelicë, 30 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Zenuni" – f.sh. Brod, 30 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Fetah Sylejmani" – Dragash, 30 litra në muaj,
- Sh.f.m.u. " Ruzhdi Berisha " – Dragash, 30 litra në muaj.

II

Për Implementimin e këtij vendimi, përkujdeset Drejtoria e Arsimit.

III

Për hapat e ndërmarr në lidhje me këtë çështje, të njoftohet kryetari i Komunës.

IV


Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 02 Nr. 404/02-804/22 i datës 11.01.2022

V

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Kryetari i Komunës
Dr. Bexhët Xheladini

- Vendimi u dërgohet:
 - Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorave të shkollave,
 - Qendra Petroll- f.sh. Plavë,
 - Arkivës.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

Komuna e Dragashit

02Nr. *100/ka-3471/22*

Dt. 22/02/2022

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g. të Ligjit nr. 03/L-040, për Qeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 55 dhe 57 pragrafi 3 dhe 6 të statusit të komunes Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

1. **Vetim Ramadani** caktohet të kryjë trajnimi për Menagjimin e Qasjes së Perdoruesve në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK.
2. **Mentor Selimi** caktohet te kryjë trajnimi për Menagjimin e Qasjes së Perdoruesve në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK
3. **Vetim Ramadani dhe Mentor Selimi** autorizohen të kryej trajnimet në klasen 11 zyrtar për nenalokime.
4. Obligohet Zyra e Kryetarit dhe zyrtaret e lartcekur për zbatimin e këtij vendimi .
5. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij

1.

Vendimi i dërgohet:

2. Zyres Kryetarit
3. Departamentit të thesarit pranë MFPT
4. Të lartëcekurve,
5. Arkivit



Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš /Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës
02 Nr. *400/01-3528/22*
Dt.22.02.2022
D r a g a s h

Në bazë të udhëzimit të zyrës së prokurimit të dt.25.01.2021 për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit, nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit nr.06-103/1 i dt.11.09.2008, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **AUTORIZOHET** Zyra e Prokurimit **TË SHPALL** tenderin: "Shërbimet e varrimit në territorin e komunës së Dragashit - (procedurë e negociuar), deri sa të shpenzohen mjetet e planifikuara me Vendim të Asamblesë Komunale 01 nr.060-22597/1 të dt.22.09.2021", duke i respektuar procedurat ligjore.
- II. Për implementimin e Vendimit **OBLIGOHET** Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse të Komunës.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Shtojcë: Udhëzimi për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit të Komunës,
- Drejtorisë përkatëse,
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
DR. Bexhet Xheladini



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Dragashit – Opština Dragaš – Municipality of Dragash

Kryetari i Komunës së Dragashit

02 Nr. 400/01-3529/22

Dt.22.02.2022

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit Nr.06-103/1 i dt.11.09.2008 dhe nenit 4, nenit 6 dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ MF-nr.01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN DHE FUNKCIONIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT

- I. FORMOHET** Komiteti i Auditimit në përbërje prej tre (3) anëtarëve:
 - 1. z.Muharrem Ibrahim** - Kryetar
 - 2. z.Kaltrina Krasniqi** - Anëtar dhe
 - 3. z.Ylber Meleqi** - Anëtar
- II.** Detyrat dhe obligimet e Komitetit janë të përcaktuara në nenet 4, 6 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2019 .
- III.** Komiteti i Auditimit duhet të mbajë së paku katër (4) mbledhje në vit dhe atë sipas modelit që gjendet në Aneksin Udhëzimit Administrativ nr.01/2019.
- IV.** Komiteti i Auditimit përgatit Raport vjetor për Menaxhmentin e lartë të Sektorit Publik-kryetarin.
- V.** Anëtarët e Komitetit të Auditimit duhet të paguhen sipas legjislacionit në fuqi siç e parasheh UA MF-NR.01/2019.
- VI.** Mandati i Kryetarit dhe anëtarve të Komitetit është tre (3) vjeçar me të drejtë riemërimi për jo më shumë se dy mandate.
- VII.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Komunës, dhe i njëjti e shfuqizon Vendimin 02 nr.400/01-28096 mbi Formimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit të dt.28.10.2019.

Vendimi u dërgohet :

- Kryetarit dhe anëtarve të Komitetit,
- Njësisë së Auditimit të Brendëshëm, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Dr.Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 404/e1-3533/22

Dt.22.02.2022

D r a g a s h

Në pajtim me nenin 12 pika c, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gaz. e R.K nr.28, e datës 4 qershor 2008), neni 43 paragrafi 3 Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02- Shpenzimi i Parave Publike, neni 32 paragrafi 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit 01. nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, e bazuar në Rregulloren për Ndarjen e Subvencioneve 01nr.060-31587/1 të dt.24.12.2019, si dhe në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, miraton këtë:

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI E MIRËQENIE SOCIALE TË KOMUNËS
PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR NDIHMË MOMENTALE PËR PËRSONAT FIZIK DHE
JURIDIK NGA FUSHA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

I. CAKTOHET Komisioni për shëndetësi e Mirëqenie Sociale i Komunës Dragash, për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë momentale nga fusha e shëndetësisë e mirëqenies sociale, në përbërje:

1. Mstan Sadiku,
2. Mimoza Berisha dhe
3. Fitim Spahiu.

II. Detyrë e Komisionit është shqyrtimi i kërkesave të qytetareve për ndihmë momentale për shërim dhe me kushte të rënda ekonomike drejtuar organeve komunale duke u bazuar në Rregulloren për Ndarjen e Subvencioneve për ndihmë momentale, për persona fizik dhe juridik, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Dragashit më dt.24.12.2019, e cila mundë të shkarkohet nga **WEB** faqja e komunës, për procedim të më tejshëm.

III. Për veprimet e ndërmarra të njoftohet kryetari i Komunës.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen derisa nuk ndryshohet me vendim tjetër.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit..., dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Dr. Behar Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/09-3704/22

Dt. 24.02.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

I

OBLIGOHET z. Fadil Sinani – zyrtar ligjor në zyrën e Prokurimit në komunën e Dragashit që të i përpilojë/hartojë dhe protokollojë të gjitha Vendimet të cilat kanë të bëjnë me zyrën e prokurimit:

- Vendimet për shpallje të tenderit,
- Vendim për hapjen e tenderit,
- Vendim për menaxher të projektit dhe menaxher të kontratës,
- Vendim për komision të hapjes,
- Vendim për vlerësim të ofertave,
- Vendim për pranim teknik, etj.

II

Në mungesë të zyrtarit ligjor të prokurimit këto punë do të i kryej z. Ylber Meleqi – zyra e Kryetarit.

III

Pas protokolimit të këtyre vendimeve një kopje i dërgohet zyrës kryetarit për arkivë, ndërsa kopjet tjera i shpërndahen nëpërmjet protokolit zyrës prokurimit, anëtarëve të komisionit dhe drejtorive përkatëse.

IV

Për implementimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunës dhe zyra e prokurimit.

V

Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Të lartëpërmendurve,*
- *Zyrës prokurimit,*
- *Arkivit kryetarit.*



Kryetari i Komunës
Dr. Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



- Kryetari i Komunës

02 Nr, 512/03 - 3907/22

Date: 28.02.2022.

Dragash

Duke u bazuar ne nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

THEMELOHET Komisioni për vlersimin e nevojave, hulumtimin e tregut, zgjidhjen e alternatives për shpenzimet e varrimit ne komunen e Dragashit ne perberje te:

1. Fadil Sinani
2. Mimoza Berisha
3. Fitim Spahiu

Vendimi u dërgohet:

-Arkivit te kryetarit

-Anëtareve të komisionit



Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini

VENDIM PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO- QEVERITARE NË FUSHËN E KULTURES RINIS E SPORTIT

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragas

KOMUNA E DRAGASHIT



U. Nr. B. 100/01-3934/22

28.02 2022

Dragash - Dragas

Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-40, dhe nenit 12 të rregullores mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës, *nxjerr këtë:*

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte të organizatave jo- qeveritare në fushën e sportit, rinisë dhe turizmit.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nën programit 85009/0820,

II

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II, të këtij vendimi përfshinë:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit, referuar paragrafit të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta

4. Forma e deklarimit të konfliktit të interesit
 5. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
 6. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
 7. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (<https://kk.rks-gov.net/dragash/category/shDalliet/thirrje-per-DL0DQzime/?page=2021>)

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit bie vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiarë do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria Për Kulturë Rini dhe Sport.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Emri plotë dhe pozita

Bexhet Xheladini — Kryetar

Data: 28.02.2022